

## LIGJ

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2016

### **PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME, PËR TRANSPORT<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për zëvendësimin e një pjese të nënprodukteve të naftës për sektorin e transportit në Shqipëri, për të kontribuar në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Kontributin Kombëtar të Synuar për reduktim të gazeve me efekt sërre si dhe për të kontribuar në përmbushjen e objektivave lidhur me përdorimin e burimeve të rinovueshme të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Ky ligj ka si qëllim përdorimin e burimeve energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve energjetike, për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngjet si dhe plotësimin e kërkesave për cilësinë e karburanteve në transport.

Neni 2

#### **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit të biokarburanteve nëpërmjet lëndëve të para djegëse, të rinovueshme, të cilat, në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.
2. Ky ligj zbatohet në veprimtarinë e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit kombëtar, kur biodiezeli dhe bioetanolit janë në përputhje me standardet evropiane, të përshtatura si standarde kombëtare nga organi kombëtar i standardizimit, ose me standardet e tjera të barasvlershme me to.

Neni 3

#### **Përkufizime**

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme", e cila shfuqizon direktivën 2001/77/KE dhe dhe Direktivën 2003/30/KE

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Biomasa**" është fraksionimi i biodegradueshem i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave të shpërbëshme organike, që përftohen si lende e pare nga veprimtaria bujqësore, e pyjeve, e peshkimit dhe veprimtarive të lidhura me to, duke përfshirë lëndët bimore, drusore dhe shtazore, dhe materiale të ngjashme industriale, si dhe fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike industriale dhe i mbeturinave të shpërbëshme organike rurale dhe urbane.

b) "**Biokarburante**" janë lëndë djegëse për sektorin e transportit, në trajtë të lëngët ose të gaztë, të cilat prodhohen nga biomasa dhe veçanërisht:

i) "**Biodizel** (dizel me prejardhje organike)" është metil-esteri yndyror dhe etil-esteri i acideve yndyrore metilike, që prodhohen nga vajra bimore (biomasa) ose shtazore dhe nga dhjamëra dhe mbetjet e vajrave dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetale dhe fraksionet e tyre të përdorura.

ii) "**Bioetanol**" është etanoli, që prodhohet nga biomasa ose nga fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike.

iii) "**Biogaz**" është lëndë djegëse e gaztë, që prodhohet nga biomasa ose fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike, industriale dhe urbane, të cilat mund të pastrohen dhe të përmirësohen, në cilësinë e gazit natyror, për t'u përdorur si biokarburant ose gaz druri.

iv) "**Biometanol**" është metanoli, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.

v) "**Biodimetiler**" është dimetileteri, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.

vi) "**Bio-ETBE**" është Etil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga bioetanol, për t'u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-ETBE-it, që përlllogaritet si biokarburant në formën e pastër, është 47 për qind e totalit të tij.

vii) "**Bio-MTBE**" është Metil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga biometanoli, për t'u përdorur si biokarburant në formën e pastër. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-MTBE-it, që përlllogaritet si biokarburant, është 36 për qind e totalit të tij.

viii) "**Biokarburant sintetik**" janë hidrokarburet sintetike ose përzierja (mishela) e hidrokarbureve sintetike, që prodhohen nga biomasa.

ix) "**Biohidrogjen**" është hidrogjeni, që prodhohet nga biomasa dhe/ose nga fraksionimi i shpërbërjes së mbeturinave organike, industriale dhe urbane, për t'u përdorur si biokarburant.

x) "**Vajra bimore të pastra**" janë vajrat që përdoren si lende e pare dhe që prodhohen nga bimë vajore energetike, me shtypje, shtrydhje ose metoda të tjera, në gjendje natyrore ose të përmirësuara, por të pandryshuara kimikisht, kur përshtaten me tipin e motorit ose të pajisjes së përdorur dhe me kërkesat përkatëse të emetimeve të ndotjeve të gazit.

xi) "**Biodizel i përzier**" është një karburant i përberë nga biodizel i pastër me dizel i prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, në raport të caktuar, me qellim përmbushjen e specifikimeve të standardit SH EN 590 në fuqi.

xii. **Biobenzine e përzier** është një karburant i përberë nga biometanol ose bioetanol te pastër me benzine e prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, ne raport te caktuar, me qellim përmbushjen e specifikimeve te standardit SSH EN 228 ne fuqi.

c) **"Biolëngjet"** janë lëndë djegëse të lëngta te prodhuar nga biomasat për përdorim për qëllime energjetike, pa përfshire sektorin e transportit, duke përfshire energjinë elektrike, ngrohjen dhe ftohjen.

ç) **"Lëndë të tjera djegëse të rinovueshme"** janë lëndët djegëse të rinovueshme, përveç biokarburanteve, që kanë prejardhje nga burime jo fosile të energjisë së rinovueshme, të cilat përdoren për qëllime transporti, sikurse janë energjia e biomasës, e gazit të landfillit, e gazit të impianteve të trajtimit të ujërave urbane dhe të biogazit.

d) **"Prodhimi i biokarburanteve"** është përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme, të prodhimit të biokarburanteve sipas përcaktimeve te mësipërme ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

e) **"Përzierja e biokarburanteve"** është procesi i përzierjes te biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të përfuara nga distilimi i naftës bruto.

dh) **"Njësi të prodhimit të biokarburanteve"** janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

e) **"Impiante për prodhimin e biokarburanteve"** janë impiantet e posaçme, ku realizohet prodhimi i biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit.

Ë) **"Impiantet për përzierjen e biokarburanteve"** janë instalime te posaçme, me mjediset e nevojshme magazinimi, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto..

f) **"Kultivim energjetik"** është prodhimi dhe tregtimi i atyre bimëve, për prodhimin e produkteve, që vlerësohen si lëndë e pare djegëse, me bazë organike te rinovueshme.

g) **"Përmbajtja energjetike"** është fuqia minimale kalorifike (termogjene) e një lënde djegëse.

#### Neni 4

### Objektivat kombëtare

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohet te arrihen këto objektiva:

a) nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, qe plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë ne përputhje me nenin 9 te këtij ligji, në sektorin e transportit kombëtar, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të shprehur në përqindje, për praninë në treg të këtyre produkteve;

b) garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. Ministria

përgjegjëse për transportin rrugor, është përgjegjëse për nxjerrjen e akteve të tjera për efektshmërisë e motorëve ekzistues në përputhje me cilësinë e karburanteve të përdorura.

c) kontributi në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit.

ç) zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe pyjeve si stimul për zhvillimin rural dhe nxitje të punësimit, duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë;

d) ulja e sasisë së emetimeve të ndotësve në ajër dhe të emetimeve të gazeve me efekt serrë , të çliruara në mjedis nga veprimtaritë në sektorin e transportit.

2. Në objektivat tregues kombëtarë vjetorë, të shprehur në përqindje, për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit, duhet të përcaktohet përqindja minimale në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në raport me sasinë vjetore të benzinës dhe diezELIT të vendosur në treg nga çdo shoqëri tregtimi me shumicë sipas nenit 11 të këtij ligji.

3. Përcaktimi i sasisë minimale vjetore në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, të cilat nuk duhet të jenë më pak se 7 për qind në volum, fillon në vitin 2016, ndërsa deri në vitin 2020, duhet të arrihet sasinë 10% të sasisë totale të konsumuar në sektorin e transportit, në përputhje me Planin e Veprimit të Energjive të Rinovueshme të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Mbas vitit 2020, kjo sasi do të vazhdojë të jetë 10%.

4. Për qëllimin e demonstrimit të zbatimit të detyrimeve kombëtare për burime të rinovueshme të energjisë, që u janë vënë operatorëve dhe të objektivave për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në të gjitha format që mund të përdoren në sektorin e transportit, të referuara në objektivat kombëtarë për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, kontributi nga biokarburantet e prodhuara nga mbeturina, mbetje, materiale celulozike joushqimore dhe materialet linjo-celulozike që rezultojnë nga mbetjet, konsiderohet të jetë dyfishi i asaj të prodhuar për biokarburantet e tjera.

## Neni 5

### **Licencimi dhe monitorimi**

1. Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

2. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose të përziera, të cilat zëvendësojnë produkte të naftës, quhen gjithashtu, nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, duke iu referuar kategorive respektive të nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj për këto kategori.

## KREU II

### **ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE TË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME**

## Neni 6

### **Impiantet për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport**

1. Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe përzierjes së tyre me nënproduktet e naftës, për transport, në impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jenë të krijuar në formën e shoqërive aksionare.
2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisur, sipas dispozitave të këtij ligji, me "leje prodhimi". Personat juridik te pajisur me "leje prodhimi" kanë te drejte te bëjnë edhe procesin e përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës.
3. Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve fillon pas certifikimit të dhënë nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në "lejen e prodhimit".
4. Impiantet e prodhimit kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre te rafineritë e naftës, shoqëritë e tregtimit me shumicë te pajisura me licencë te llojit A, te shoqëritë e tregtimit me pakicë, tek konsumatorët e mëdhenj dhe t'i eksportojnë.
5. Impiantet për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë, ne përputhje me standardet ne fuqi, te cilat janë kthyer ne rregull teknike.
6. Impiantet për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për sasinë dhe cilësinë e hedhur ne tregun e brendshëm.
7. Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga impiantet për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen me urdhër nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet informon publikun për cilësinë e biokarburanteve dhe përgjigjet për përpunimin dhe botimin e këtyre të dhënave, sipas formës, afateve dhe mënyrës së botimit të përcaktuar.

## Neni 7

### **Përgatitja për tregtim e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme**

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, mund të ruhen, magazinohen, transportohen dhe të tregtohen vetëm kur përmbushin standardet teknike ne përputhje me Nenin 6 pika 5 te këtij ligji.
2. Ruajtja, magazinimi, transportimi dhe përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë dhe të sigurisë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto realizohet vetëm në instalimet e posaçme dhe në përgjegjësinë e personave juridikë të pajisur me “leje prodhimi” dhe /ose “Leje për përzierje” si dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me leje koncesioni, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Impiantet e prodhimit, të cilat tregtojnë biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të disponojnë instalime për depozitimin e tyre dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të naftës bruto. Këto shoqëri përgjigjen për funksionimin e këtyre instalimeve, në përputhje me normat teknike, të miratuara nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet dhe me masat e mbrojtjes nga zjarri (MNZ).

5. Impiantet që kryejnë vetëm procesin e përzierjes, të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto duhet të pajisen me “Leje për përzierje” nga Ministri përgjegjës për hidrokarburet. Kushtet dhe kriteret për dhënien e “Lejes së Përzierjes” miratohen nga Këshilli i Ministrave pas propozimit të Ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

6. Instalimet, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina doganore, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

7. Strukturat tatimore dhe doganore dhe Inspektorati Shtetëror Përgjegjës , organizojnë dhe ushtrojnë kontroll ndaj personave juridikë që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore, që lidhen me rezultatin financiar të tyre dhe plotësimin e detyrimeve fiskale e doganore ndaj shtetit, për kontrollin e treguesve cilësorë e sasiore, si dhe të normave të tjera ligjore e nënligjore për parandalimin e abuzimeve e falsifikimeve, që nga çasti i hyrjes së mallit në pikat doganore, deri në procesin përfundimtar të shitjes së tyre.

## Neni 8

### **Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme**

1. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierje me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, realizohen nga impiantet e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me leje koncesioni. Shoqëritë e pajisura me "Licence" të llojit A për tregtimin me shumicë të nënprodukteve të naftës kanë të drejtë të tregtojnë nënprodukte të naftës me përzierje biokarburantesh, si dhe të realizojnë përzierje, pasi të jenë të pajisur me “Leje për përzierje”.

2. Shoqëritë e tregimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me "licence tregimit me pakice", sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante në formë të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duke zbatuar standardet shtetërore dhe dispozitat e këtij ligji. Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve shqyrton dhe përditëson në kohën e duhur në konsultim me palët e interesuara standardet e reja, të cilat duhet të jenë të njehsuara me ato Evropiane.

3. Në dokumentacionin përkatës doganor dhe administrativ shoqëruet të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duhet të përcaktohet në mënyrë të detyrueshme përqindja e biokarburanteve ose e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përzihet me nënproduktin respektiv të përpunimit të naftës bruto.

4. Zotëruesit e licencës për tregtimin me shumicë dhe të licencës për tregtimin me pakicë të nënprodukteve të naftës, të cilët tregtojnë edhe biokarburante janë të detyruar që në instalimet e tregimit

ose në pikat e shitjes së tyre të afishojnë ne reklamat dhe pompat e karburantit, në mënyrë të dukshme dhe të qartë, një shënim të posaçëm për:

- a) biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme;
- b) biodiezelin e përzier me diezel, për lëvizje automjetesh, me përqindje mbi standardet ne fuqi, bioetanolin e përzier me benzinë, në përqindje, mbi standardet ne fuqi. Karakteristikat e shënimit të posaçëm përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, i cili botohet në Fletoren Zyrtare.

5. Veprimtaria e transportimit dhe tregtimit te lendeve djegëse për transport, te cilat kane ne përbërje te tyre edhe biokarburante, behet sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

## Neni 9

### **Kriteret e Qëndrueshmërisë se Biokarburanteve**

1. Pavarësisht nëse lendet e para që kanë shërbyer për prodhimin e biokarburanteve janë kultivuar brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, energjia e prodhuar nga këto biokarburantet apo biolëngjet, merret ne konsiderate sipas qëllimeve te përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, vetëm nëse respekton kriteret e qëndrueshmërisë te përcaktuara ne ketë nen.

2. Energjia e prodhuar nga biokarburantet apo biolëngjet, merret në konsideratë për qëllimet si më poshtë:

- a) për përmbushjen e objektivave kombëtar te burimeve te rinovueshme te energjisë ne sektorin e Transportit;
- b) për pajtueshmërisë me detyrimet e vendosura nga legjislacioni dhe Plani Kombëtar për Burimet e Rinovueshme te Energjisë;
- c) për mbështetjen financiare për konsumin e biokarburanteve dhe biolengjeve te prodhuara ne territorin e Shqipërisë.

Biokarburantet dhe biolëngjet e prodhuara nga mbeturinat dhe mbetje të tjera nga mbetjet bujqësore, akuakulturore, nga peshkimi dhe nga mbetjet e pyjeve, duhet te përmbushin vetëm kriteret e qëndrueshmërisë te përcaktuara ne pikën 3 të këtij neni, për qëllimet e përcaktuara në shkronjat a), b) dhe c).

3. Reduktimi i emetimeve te gazeve serë, nëpërmjet përdorimit te biokarburanteve dhe biolengjeve duhet te jetë të paktën 35%.

Rregullat për llogaritjen e ndikimit ne uljen e sasisë se gazeve me efekt sere nga prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe biolengjeve përcaktohen me Urdhër te Ministrit përgjegjës për mjedisin.

4. Biokarburantet dhe biolëngjet te marra ne konsideratë sipas qëllimeve te përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nuk duhet të jenë të prodhuara nga lëndë të para të përfutuara nga zona me vlera të larta biodiversiteti, si më poshtë:

- a) pyje dhe terrene pyjore, ku nuk ushtrohen aktivitete të njeriut dhe ku proceset ekologjike nuk janë modifikuar ne mënyrë te dukshme;
- b) zonat të përcaktuara për qëllimet si më poshtë:
  - i) zona të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi; ose,
  - ii) zona ku janë të caktuara mbrojtja e ekosistemeve apo specieve të rralla, te kërcënuara ose të vena në rrezik zhdukjeje.
- c) kullota natyrore me vlere të lartë biodiversiteti, konkretisht:

- i) kullota të cilat do të mbeten të njëjtat nëse nuk do ketë ndërhyrje njerëzore dhe që ruajnë përbërjet e specieve natyrore si dhe karakteristikat dhe proceset ekologjike;
- ii) kullota jo natyrore, që nuk do ishin të tilla në mungesë të ndërhyrjes njerëzore dhe që janë të pasura dhe jo të degraduara, përveç faktit nëse nuk dëshmohet që korrja e lendeve të para është e nevojshme për të ruajtur statusin e saj si kullote.

5. Biokarburantet dhe biolëngjet të marra në konsideratë për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nuk duhet të jenë të prodhuara nga lende të para të përfuara nga toka të cilat kanë një përqendrim të madh karboni. Për qëllim të këtij përcaktimi, konsiderohen tokat si më poshtë:

- a) Zona me lagështirë, ose terrene të mbuluara ose të ngopur me ujë, në mënyrë të përhershme ose për pjesën më të madhe të vitit;
- b) Zonat pyjore të shtrira në më shumë se një hektar dhe të karakterizuara nga pemë të gjata mbi 5 metra dhe nga një mbulim i sipërfaqes mbi 30%;
- c) Toka që kanë një zgjerim në më shumë se një hektar dhe të karakterizuara nga prania e pemëve me një lartësi mbi 5 metra dhe një mbulim të sipërfaqes përfshirë midis 10% dhe 30%.

6. Biokarburantet dhe biolëngjet të marra në konsideratë për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nuk duhet të jenë të prodhuara nga lende të para të përfuara nga një tokë që është moçal, përveç kur jepen fakte që kultivimi dhe mbjellja e këtyre lëndëve të para nuk përbën kullim të tokës, e cila nuk ishte kulluar me pare.

## Neni 10

### **Verifikimi i Kritereve të Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve**

1. Për marrjen në konsideratë të biokarburanteve dhe biolëngjeve, struktura përgjegjëse për verifikimin e kritereve të qëndrueshmërisë verifikon nëse operatorët ekonomikë kanë respektuar kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji. Për këtë qëllim, operatorët ekonomikë janë të detyruar:

- a) Të lejojnë që sasi të lendeve të para ose biokarburante me karakteristika të ndryshme qëndrueshmërie të përzihen;
- b) Të informojnë mbi karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe mbi volumet e përzierjeve të përmendura në pikën a) dhe ti mbajnë ato të pandryshuara.
- c) Të sigurojnë që shuma e sasive të përdorura nga përzierja të ketë njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë, sa shuma e të gjithave volumeve që i janë shtuar përzierjes.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet, përcakton metodologjinë dhe strukturën përgjegjëse për verifikimin e plotësimit të kritereve të qëndrueshmërisë të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.

3. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet, i raporton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi masat kombëtare të marra për respektimin e kritereve të qëndrueshmërisë të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji.

## Neni 11

### **Përlllogaritja e sasisë vjetore minimale të konsumit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme**



1. Përlllogaritja e përqindjes minimale vjetore të konsumit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhet në bazë të përmbajtjes energjetike të totalit të lëndëve djegëse (diezellit dhe benzinës) që tregtohen për transport.

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të hidrokarbureve, miraton udhëzimin për mënyrën e përcaktimit të sasisë vjetore minimale të vendosur në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për sektorin e transportit dhe të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, përcakton sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit.

3. Të dhënat për sasinë minimale të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit gjatë vitit pasardhës, publikohen në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe të ministrisë përgjegjëse për transportin.

4. Secila shoqëri e pajisur me licencë të llojit A për tregtimin me shumice në treg duhet të garantojë sasi të minimale të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme vjetore të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 2 të këtij neni. Këto sasi duhet të certifikohen për plotësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë të përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji. Strukturat e Ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet përgjigjen për kontrollin e plotësimit të sasive minimale vjetore të biokarburanteve që duhet të vendosen në treg.

5. Parashikimi në pikën 4 të këtij neni nuk kufizon të drejtën e shoqërive për të tregtuar sasi edhe më të mëdha, në përputhje me kërkesën e tregut dhe standardin për përmbajtjen në volum të lëndëve të rinovueshme.

6. Kur prodhimi vjetor vendas i këtyre produkteve, nuk mbulon të gjithë sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për t'u hedhur në treg, shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me "licencë tregtimi" të llojit A për nënproduktet e naftës, detyrohen të garantojnë furnizimin e tregut me këtë sasi minimale vjetore.

7. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet raporton pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, sipas procedurave të përcaktuara me Urdhër të Këshillit të Ministrave.

## Neni 12

### **Leja e prodhimit dhe Leja për përzierje**

1. Personat juridikë të organizuar si njësi për prodhimin e biokarburanteve, në përputhje me përcaktimin e pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, pajisen me "leje prodhimi" dhe "leje për përzierje" për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit dhe të përzierjes të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kur plotësojnë kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Leja e prodhimit dhe ajo e përzierjes jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e impiantit të prodhimit/përzierjes të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Leja e prodhimit dhe Leja e përzierjes së biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, jepet për një afat 20 vjet, me të drejtë ri përsëritjeje.

4. Shoqëritë e pajisura me "leje prodhimi" dhe "leje për përzierje" kanë te drejte të kryejnë edhe veprimtarinë e tregimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji . Shoqëritë e pajisura me "leje prodhimi" kanë te drejtën dhe te përzierjes se biokarburanteve me nënproduktet e naftës, për transport.

5. Për një konkurrencë transparente, zotëruesit e "lejes së prodhimit" për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, dhe ato që zotërojnë "lejen për përzierje" detyrohen të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet analizën e çmimit të prodhimit në fabrikë (ex factory) të këtyre produkteve.

### Neni 13

#### **Inspektorati Shtetëror Përgjegjës**

1. Organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të ushtruar nga personat juridik në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të strukturës përgjegjëse për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë sipas nenit 10 të këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, në varësi të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

2. Inspektorati Shtetëror Përgjegjës përgjigjet:

a) për kontrollin në zbatimin dhe respektimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve të prodhimit dhe përzierjes si dhe pajisjeve përkatëse, nga personat juridik që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

b) për kontrollin dhe zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet, licencat apo autorizimet përkatëse, që janë dhënë personave juridik, që ato të respektojnë normat dhe kushtet teknike.

c) për kontrollin dhe respektimin e tregueseve cilësore të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë në forme të pastër ose të përzier.

ç) për kontrollin dhe kryerjen e analizave në laboratorin qendror të Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sasi të importuara, para zhdoganimit, për sasi të biokarburanteve të prodhuara në vend, si dhe për kontrollin përpara shpërndarjes në stacionet e shitjes të karburantit.

d) shkëmbimi i informacionit midis Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës dhe strukturave doganore e tatimore, behet në momentin e prodhimit ose importimit përpara hedhjes të produkteve në treg. Ky informacion ka për qëllim vlerësimin e cilësisë të produktit në përputhje me standardet shtetërore në fuqi.

### Neni 14

#### **Regjimi tatimor**

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit, si dhe lëndët e para, që përdoren për prodhimin e tyre, të cilat duhet të certifikohen në lidhje me plotësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë të përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji, u nënshtrohen një trajtimi të veçantë fiskal, që i bën ato të konkurrueshme në treg.

Në periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2020, niveli i akcizës për biokarburantet e pastra të prodhuar në vend do të jetë zero.

2. Janë subjekt i një regjimi të veçantë doganor dhe taksash të gjitha makineritë, materialet dhe pajisjet, që shërbejnë dhe janë pjesë e objekteve të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me të cilat, por pa u kufizuar vetëm në to, nënkuptohen:

a) pajisjet dhe makineritë, që shndërrojnë plehun organik në përmirësues organik të tokës, që përdoret për kultivimin energjetik;

b) pajisjet, materialet dhe makineritë bujqësore, që do të përdoren nga fermerët vendorë për kultivimin energjetik;

c) pajisjet dhe makineritë teknologjike, kryesore dhe ndihmëse, të impianteve të prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Për periudhën e parë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2020, taksa doganore dhe TVSH-ja për këto pajisje, materiale dhe makineri është zero.

3. Përdoruesve të biokarburanteve do t'u njihen si shpenzime të zbritshme faturat e furnizimit me biokarburant në funksion të aktivitetit ekonomik të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, apo si shpenzime të zbritshme për individët që deklarojnë të ardhurat individuale vjetore, në përputhje me normat e lejuara të legjislacionit tatimor.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të domosdoshëm, që duhet të plotësojnë subjektet, për të përfituar këto lehtësi, sikurse përcaktohet në pikat 1 e 2 të këtij neni.

### KREU III

#### DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

#### **Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkeljet e pikës 4 të nenit 6 të këtij ligji, me 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

b) shkeljet e pikës 5 të nenit 6 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

c) shkeljet e pikës 6 të nenit 6 të këtij ligji, me 100 000 lekë deri në 150 000 lekë;

ç) shkeljet e pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

d) shkeljet e pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 8 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë.

dh) Për shkelje të pikës 4 të nenit 11, të këtij ligji, me 50 për qind të vlerës së tregut të sasisë së produktit që mungon nga kuota minimale e përcaktuar, por në çdo rast jo më pak se 5 milion leke për çdo shkelje.

e) Për shkelje te nenit 11, pika 6 te këtij ligji, me 500 000 – 700 000 leke.

2. Kur veprimtaria ushtrohet pa lejet përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, subjekti gjobitet me 4 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

3. Për shkelje te përsëritura deri ne tre here për zbatimin e dispozitave te këtij ligji automatikisht leja e tregtimit behet e pavlefshme, ISHP njofton organin përgjegjës duke bere bllokimin e zhvillimit te aktivitetit.

Masa e gjobës për pikat 1.a, b, c, d, f jepet nga ISHP, ndërsa për shkeljet e gërmës “c” dhe pikës 2 jepet nga Ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

5. Te ardhurat e përfituara nga gjobat derdhen tërësisht ne buxhetin e shtetit.

#### Neni 16

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashte muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 2, nenit 11 pika 1, nenit 12 pika 1 dhe nenit 14 pika 4 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për hidrokarburet që brenda gjashte muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të nenit 6 pika 7, nenit 7 pika 2 dhe 4, neni 8 pika 4 dhe neni 11 pika 7 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin rrugor që brenda gjashte muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 1 të këtij ligji.

4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin që brenda gjashte muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të nenit 9 pika 3 të këtij ligji.

#### Neni 17

##### **Shfuqizime**

Ligji 9876, date 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” shfuqizohet.

#### Neni 18

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.